



Republika E Kosovës  
Republika Kosova  
Republic Of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPSTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

I	Data	02.10.20	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		370/01-24611	

## KONTRATË PUNE

Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti NTSH "AR DRITI", nga Ferizaji përfaqësuar nga Nehat Dalloshi (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

### Renovimi i objekteve kolektive banesore

me numër identifikues: KA652/20/059/521

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

### Renovimi i objekteve kolektive banesore

në <sipas dosjes> pjesë

#### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total është 43,239.91 € ,

dhe me fjalë (Katërdhjetëetremijëedëtridhjetëenëntëeuro e 91/100 centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .

#### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.



4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

#### Për Kontraktuesin

#### Për Autoritetin Kontraktues

<b>Emri:</b>	Nehat Dalloshi	<b>Emri:</b>	Shefket Koxha
<b>Pozita:</b>	Drejtor	<b>Pozita:</b>	Menaxher i Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	02.10.2020	<b>Data:</b>	02.10.2020
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	



**PJESA III E KONTRATES**

**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>[SHQIPE]</b> .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <b>[shëno shumat]</b> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <b>[shëno shumat]</b> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <b>[shëno shumat]</b> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <b>[shëno shumat]</b> (ii) të personave të tjerë: <b>[shëno shumat]</b>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <b>[shëno numrin]</b> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>[shëno numrin]</b> ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: <b>Betim Shala</b>
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë prej <b>05.10.2020</b> ku e gjith plani artohet në ditarë ndërtimor.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë brenda <b>50 ditëve</b> .
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë (një vitë) nevlere prej 10 % të vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>[shëno numrin]</b> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>[0.25 %]</b> për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha

		Punët është 20 %] e Çmimit final të Kontratës.
Kushtet e pagesës	20.1	<b>Kushtet e pagesës janë:</b> Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve .
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[shëno përqindjen]</i>
Siguria e ekzekutimit	22.1	<b>Shume e sigurisë së ekzekutimit është 4,323.99€</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore, në rast se nuk zgjidhet në mënyrë miqësore kompetente është Gjykata komunale Kaçanik.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<i>[shëno të dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatës Komunale Kaçanik</b>  b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i> .

Paramasa per l'yerjen e objekteve shumebanesore					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	C.nj	Shuma
1	Gërryerja e fasadës egzistuese në vendet e dëmtuara. Në llogari hyn skelet dhe pastrimi i terenit pas gërryerjes. Llogaria të bëhet për m <sup>2</sup> të sipërfaqes e cila duhet të punohet.	m <sup>2</sup>	4965.5	1.2	5958.6
2	Pastrimi i tullave të kuqe me brusha speciale ( për mos dëmtimin e tyre ), njëherit duhet të bëhet edhe pastrimi i fugave të tullave. Në llogari hyn skelet dhe pastrimi i terenit pas gërryerjes. Llogaria të bëhet për m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	2895.5	1.3	3764.15
3	Sigurimi i materialit, transportit dhe ljerja e tullave të kuqe me llak adekuat pa ngjyrë. Në llogari hyn edhe skelet. Llogaria të bëhet për m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	2450	2	4900
4	Sigurimi i materialit, transportit dhe punimi i sipërfaqes të gërryer me material të gatshëm si : rrieta rabic, ngjitës dhe fasad. Në llogari hyn edhe skelet. Llogaria të bëhet për m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	4965.5	3	14896.5
5	Sigurimi i materialit, transporti dhe ljerja e fasadës së jashtme në dy shtresa me ngjyrë të rezistueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Ngjyra duhet të jetë e përshatshme me objektet përreth me miratimin e organit mbikqyrës. Në llogari hyn edhe skelet. Llogaria të bëhet për m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	5965.5	2.3	13720.65
	Gjithsej				43239.9

punoi: Jehona Dervishi  
Betim Shala

